

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "N.N.Z.K SHKODRA" SH.P.K

Në zbatim të vendimit të ortakut të vetëm ZYBER PADIL KRAJA, të shoqërisë "N.N.Z.K SHKODRA" SH.P.K, të datës 2.05.1995, u përfundua në përputhje me legjislacionin shqiptar në faqi Akti Themeltar i saj.

I. FORMIMI

1. Formimi i Shoqërisë

Konstituenti Zyber Kraja krijoi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "N.N.Z.K.Shkodra", në përputhje me kromin e katërt të ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqërit tregtare".

2. Emëri

Emëri i shoqërisë do të jetë "N.N.Z.K.Shkodra" SH.P.K

3. Qëllimi dhe Objekti i Shoqërisë

Qëllimi dhe objekti i shoqërisë do të jetë: Kat 2 (elek)- ndertime civile, industriale, Turistike, bujqësore etj. dhe kompletimi me instalime e nevojshme për to. Kat 12 - d, e, f, g. Për zbatim: Kat 1- punime dheu muratur, betoni, b/arme të zakonshme, punime shembjesh; prodhim materiale ndertimi, Kat 2 - ndertime civile, industriale, Turistike, bujqësore etj dhe kompletime me instalimet e nevojshme për to. Kat 3 - puni e restauri Kat 17 - mirëmbajtje dhe punime shërbimi të zakonshëm të sistemit Kommu Transporti në tërësi të shoqërisë, transporti për të tretët, karburante dhe Hidro karburante me shumicë dhe me pakicë, lëndë djegëse, vaj guri, gaz, solar etj, prodhime bujqësore dhe blegtozale, industriale, ushqimore, Elektro Shtëpiajke. Si dhe çdo op racion që bashkohet me veprimtarit e mësipërme dhe që konsiderohet i përshatshëm dhe me leverdi për vritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë. Të Eksport - Import.

4. Selia

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Lagjen "Vojo Kushi" Shkoder. Sipas vendimeve të miratuara në përputhje me statutin e shoqërisë ajo mund të hap degë, zyra filiale, apo përfaqësi në qytete të tjera të shqiptarisë shtu dhe jashtë.

5. Afati i Shoqërisë

Kohë - zgjatja e shoqërisë përcaktohet deri me datën 31.12.2005, si datë fillestare do të merret data 2.05.1995, datë e nënshkrimit të akt marëveshjes së parë për krijimin e saj.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek dhe përbehet si kontribut i ortakut të vetëm.

7. Kapitali Social

Kapitali social është derdhur në llogarin bankare pranë bankës Shqiptare

8. Libri i Shoqërisë

Për të precizuar e saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çel librin e vet që do të quhet "Libri i Shoqërisë".

9. Viti Financiar

Viti Financiar do të mbyllet me 31. dhjetor, të vitit në veshdim.

II. KAPITALI

1. Kontributet e Kapitalit

Sasia e kapitalit social derdhur sipas dispozitave 6 të kësaj akt marrëveshje do të quhet "Kontribut Kapital".

Kontributi Kapital fillimisht do të përdoret për sh pënzimet fillestare të shoqërisë.

2. Financimi

Në masën e duhur shoqëria "N.N.Z.K Shkodra", ka të drejtë të sigurojë financim tregtar, ose investues nga çdo bankë e institucion financiar, të huaj ose shqiptar, financim ky që do të rregullohet me anë të kontratave ose marrëveshjeve të posaçme.

3. Qeshtjet Financiare dhe llogaritë e shoqërisë;

Shoqëria "N.N.Z.K Shkodra" do të mbajë llogaritë duke u mbështetur te leku shqiptar e te vulltet e forta.

Shoqëria do të ketë si vit kalendarik si vit fiskal.

III. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

1. Qendra e Shoqërisë

Qendra e shoqërisë do të jetë në Lagjen "Vojo Kushi" Shkoder.

2. Drejtimi i Shoqërisë

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë ortakët i vetëm.

3. Administrimi


Shoqëria do të administrohet nga ortakët i vetëm.

IV. DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt themelimi u hartua në Shkoder, me datën 2.05.1995, me tre ekzemplar në gjuhën shqipe, duke patur secili të njëjtën vlerë.

ORTAKU I VETËM

/ Zyber Radil Kraja /



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E NOTERISË

Nr. Repertorit: 407

Nr. Koleksionit: 383

AUTENTIFIKIM - MËNSHKRIMET

Sot me datën dy të majit maj njëmbëdhjetë e nëntëdhjetë e pesë (2.05.1995), ditën e martë në Zyren e Noterisë dhe përpara meje Bërhan Malevi, noter publik, me seli në Shkoder, u paraqitë personalisht

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "N.N.Z.K SHKODRA" SH.P.K

Ky statut u përfundua në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë në fuqi, me datën 2.05.1995, në Shkoder, nga z. Zyber Fadil Kraja, i dtline 1959, lindur në Shkoder dhe banues në Lagjen "Vojo Kushi" Rruga "Gjirimi" Nr.1050 Shkoder, i quajtur ortak i vetëm, me vullnet të lirë krijoi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

KRSU I

FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHË - ZGJATJA

NENI 1

FORMA

Zoti Zyber Kraja, i quajtur ortak i vetëm, me përmbajtjen e këtij statuti është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e këtij statuti.

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë do të jetë "N.N.Z.K Shkodra" SH.P.K

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Lagjen "Vojo Kushi" Shkoder. Me vendim të ortakut të vetëm mund të hapen degë, zyrë, filiale, ose përfaqësi në qytete të tjera të shqipërisë ose jashtë saj.

NENI 4

KOHË - ZGJATJA

Shoqëria do të ketë një kohë - zgjatje deri me 31.Dhjetor.2005, me përjashtim të rasteve kur kërkohet kohë -zgjatje ose prishje të parakohëshme. Si ditë fillestare merret dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e Tiranës.

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt: Kat2(Elek)- ndertime civile, Industriale, Turistike, bujqësore etj, dhe kompletim me instalimet e nevojshme për to. Kat 1- d. e. f. g. Për zbatim Kat 1- punime dheu, muratur, betoni, b/arme të zakonshëm, punime sh embjesh, punime material ndertimi, Kat 2 -ndertime Civile, Industriale, Turistike, bujqësore etj, dhe kompletim me instalimet e nevojshme për to. Kat3- punime restaurimi, Kat4- mirëmbajtje dhe punime shërbimi të zakonshëm të sistemit Komunal, Transporti në tërësi shoqërisë, transporti për të tretët, Karburante dhe Hidro Karburante me shumicë dhe me pakicë, lëndë djegëse, vaj guri, gaz, solar etj, prodhim bujqësore dhe blegtorale, Industriale, Ushqimore, Elektro Shtëpiake. Si dhe çdo operacion që bashkohet me veprimtarit e mësipërme dhe që konsiderohet i përshatit shëm dhe me leverdi për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm.

shëm të shoqërisë të Eksport - Import.

KREU II

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek. dhe përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm.

KREU III.

NENI 7

DREJTIMI I SHOQËRISË

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë ortakut i vetëm.

NENI 8

PROÇES - VERBALET

Vendimet e ortakut të vetëm duhen hedhur në proces - verbal, i cili nënshkruhet prej tij.

NENI 9

ADMINISTRIMI

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm.

NENI 10

FUQIT E ORGANIT ADMINISTRATIV

Organi administrativ ka kompetenca të gjera që përfshin të gjitha veprimtaritë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe gjithçka tjetër të parashikuar me ligj.

NENI 11.

KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV

Organi administrativ ka kompetenca:

- Të marrë pjesë në ankanda.
- Të marrë pjesë në procedurat e falimentimit.
- Të përpiloj kontratat dhe çdo akt tjetër juridik që ka të bëjë me veprimtarinë e shoqërisë.
- Të blejë të këmbel, të tjetërsoj pasuri të luitëshme të saj dhe aksione.
- Të themelojë dhe të ndryshojë servitute dhe të drejta të tjera reale.
- Të hap llogari rrjedhëse bankare pranë bankave Shqiptare brenda dhe jashtë shtetit.
- Të marrë obligacione dhe të këmbel eto. të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera financiare e gjithfarë llojesh.
- Të fillojë procedurë gjyqësore e të mbrohet ndaj veprimeve juridike gjyqësore dhe administrative në çdo lloj gjendje dhe grade qofshin.
- Të emëroj kur është rast arbitre pajtues e të nënshkruaj kompromis e ai dhe të bëjë transaksione:
- Të emëroj drejtor administrativ dhe nëpunës të rangjeve të ndryshme për veprime të veçanta teknike ose për një kategori të caktuar veprimesh :

- Të bëjë gjithëka tjetër që e konsideron të dobishme që është në përputhje me frymen e këtij statuti e të aktit themelues, si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin social shoqërisë.

- Ky përcaktim për kompetencat e organit administrativ është tregues taksativ, e prandaj nuk e kufizon fuqit që i takojnë organit administrativ.

NENI 12

PËRPAQËSIMI

Firma dhe përfaqësimi i shoqërisë përballë të tretëve dhe përpara gjyqit është e drejtë dhe detyrë e administratorit të vetëm.

KREU IV

NENI 13

VITI FINANCIAR LLOGARITE VJETORE

Çdo vit financiar fillon me datën 1. Janar dhe përfundon me datën 31. Dhjetor, përjashtimisht viti i parë financiar, mund të fillojë pas datës 1. Janar, 1995, do të përfundojë me datën 31. Dhjetor, 1995.

Llogarit vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e kryera, gjat vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori ose eventualisht edhe nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 14

PITIMI

Pitimi neto i bilancit shpërndahet si vijon:

a) 5 % destinohet për të krijuar fondin e rezervës së thjeshtë deri sa ky të mbërrijë në një të pesten e kapitalit themelues, ose eq sa ortaku i vetëm do ta quaj të nevojshëm rast pas rasti, në rast se rezerva është ulur nën një të pesten deri sa të integrohet e tëra.

b) Mbetja do të shpërndahet konformë vendimit të ortakut të vetëm.

NENI 15

ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit të shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut mund të vendoset nga ortaku i vetëm.

NENI 16

PRISHJA

Shoqëria prishet në përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 4 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 4 kur ka prishje të parakohshme për arsye që parashikohen në ligj.

KREU V

DISPOZITA TË PUNDIT

NENI 17

SHTIMI I ORTAKËVE

Kur ortakut i vetëm është dakort që të bëhet shtesë kapitali me anë të personave të tjerë, që këta të konsiderohen ortak vepronët kështu:

- a) Në pari shqyrtohet kërkesë me sh krim e të interesuarit, merret vend nga ortakut i vetëm, bëhet pranimi dhe përcaktohet kuota e kapitalit që do të derdha ortakut i ardhshëm :
- b) Në dyti bëhet rregjistrimi në librin e ortakëve, ku shkruhet emëri plotë i ortakut të ri dhe kuota që i përket në kapitalin themeltar.
- c) Në treti veprimi i bankimit të ortakut të ri bëhet me akt noterial.

NENI 18

AMENDAMENTET

Këti akti (Statuti) mund të bëhen amendamente sa herë që ortakut i vetëm e sheh të arsyshëm.

NENI 19

VENDI DHE KOHA E HARTIMIT TË STATUTIT

Ky statut u hartua në Shkodër, me datën 2.05.1995, në tre ekzemplar në gjuhën shqipe, duke pasur të gjitha tekstet të njëjten vlerë.

ORTAKU I VETËM

/ ZYBER PADIL KRAJA /

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

ZYRA E NOTERISE 6

Nr. Repertorit: 407

Nr. Koleksionit: 382

AUTENTIFIKIM - NENSHKRIMI

Sot me datën dy të mujit maj njëmbëdhjetë e nëntëdhjetë e pesë (2.05.1995), ditën e martë në Zyrën e Noterisë dhe përpara meje Bërhan Malevi, noter publik, me seli në Shkodër, u paraqitë personalisht ortakut i vetëm. Për identitetin e të cilit u sigurova në bazë të letër - njoftimit të tij personal dhe pasi konstatova se ka të gjitha aftësit e kërkuara nga ligji, i vertetova vullnetin, përmbajtjen si dhe nënshkrimin e tij si më sipër rezultoi:.....

NOTERI

Bërhan Malevi /

